



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

DATË/A:	28.03.2019
REFERENC-Ë:	46.03.19
PËR/ZA/TO:	Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Kuvendi i Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bislim Zogaj / Drejtor – AMKMK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i AMKMK-së për 2018

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Përmes kësaj shkrese iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2018.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2018;
- Planin e punës së AMKMK-së për vitin 2019.



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

**AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE
TË KOSOVËS**

Raporti Vjetor i Punës së AMKMK-së për vitin 2018

Përmbajtja

1. Përmbledhje Ekzekutive	4
2. Korniza Ligjore	5
3. Fushëveprimi i Agjencisë	6
4. Organizimi i Agjencisë	7
4.1. Organogrami i AMKMK-së.....	7
4.2. Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2018.....	8
4.3. Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2019.....	8
4.4. Tabela e Trajnimeve 2018.....	9
4.5. Plani i trajnimeve të nëpunësve	10
4.6. Asetet që ka në disponim AMKMK.....	16
4.7. Hapësira për punë.....	23
5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese.....	24
5.1. Planet që parashikohen për vitin - 2018.....	25
6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit).....	29
7. Raporti Financiar.....	30
8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.....	32
9. Shtojcat.....	35

1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është themeluar në vitin 2013 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së, dhe pas publikimit të GZRK/Nr.9/ datë 26.04.2013.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale është institucion i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit, Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë aspekt, AMKMK do të paraqesë raportin vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet relevante dhe lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK-së.

Agjencia mbikëqyrë, përkujdeset, menaxhon aktivitete të ndryshme lidhur me Komplekset Memoriale në Kosovë.

Agjencia bën mbrojtjen, konservimin, restaurimin, ruajtjen dhe promovimin sipas legjislacionit në fuqi.

AMKMK harton Akte nënligjore nxjerrë vendime, rekomandime, dhe nxjerrë Memorandume dhe Marrëveshje Bashkëpunimi në koordinim me nivelin lokal dhe qendror.

Në këtë raport disa nga objektivat kryesore janë:

- Planifikimi, projektimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja e Komplekseve Memoriale;
- Buxheti i AMKMK-së dhe;
- Rekrutimi i stafit të Agjencisë.

Arritjet e AMKMK-së për vitin e raportimit 2018 janë: përmbushja e infrastrukturës ligjore sidomos nxjerrja e legjislacionit sekondar sipas Ligjit të AMKMK-së, dhe hartimi i akteve nënligjore, vendimeve sipas Ligjit Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, dhe realizimi i objektivave të disa projekte duke pasur parasysh buxhetin e vogël.

Sfidat në të ardhmen parashihen rritja e buxhetit të AMKMK-së, për planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e shumë Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe shtimi i numrit të punëtorëve, si dhe bartja e të gjitha projekteve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në AMKMK.

2. Korniza Ligjore

Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë është Ligji Nr.04/L-146 për AMKMK-në (GZRK) Nr.9/ datë 26.04.2013, që deri me tani nuk ka pasur ndonjë ndryshim, plotësim dhe as vështirësi në zbatim të Ligjit.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës funksionon në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Agjencia ka Rregulloren e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK.

Në këtë Agjenci janë nxjerrë këto Akte nënligjore:

- Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemën e Agjencisë së AMKMK-së;
- Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së;
- Rregullorja Nr.05/2016 për punët në Teren, punët Shtesë;
- Rregullorja Nr.06/2017 për Krijimin e të Hyrave.

Pas aprovimit të Ligjit Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz-GZRK Nr.19, ka filluar procedura e nxjerrjes së vendimeve dhe akteve nënligjore. Sipas Ligjit në fuqi, me propozim të Agjencisë, vendimet dhe akti nënligjor miratohet në Qeveri.

Në procedurë të hartimit në AMKMK është Projekt Rregullorja për Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

3. Fushëveprimi i Agjencisë

Misioni: Krijimi i mundësisë për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në Planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës.

Vizioni: Kompletimi dhe funksionimi i Agjencisë, angazhimi në ngritjen dhe funksionalizimin e Komplekseve Memoriale, në mënyrë dhe në funksion të shtimit të numrit të vizitorëve.

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:


- Projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimi i programeve kërkimore - shkencore, aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimi i Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- Inicimi i procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- Hartimi i planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimi i planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- Propozon shpalljen e zonave me interes të veçantë kombëtar dhe me karakter historik.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës sipas organogramit ka dy Departamente: Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim i cili ende nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së buxhetit.

4. Organizimi i Agjencisë

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord.

4.1. Organogrami i AMKMK-së



4.2. Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2018

AMKMK në vitin 2018 kishte të punësuar dymbëdhjetë (12) nëpunës në këto kategori funksionale:

Nr.	Kategoritë funksionale	Numri i të punësuarve
1.	Niveli i lartë drejtues	1
2.	Niveli drejtues	5
3.	Niveli profesional	4
4.	Niveli tekniko administrativ	2

4.3. Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2019

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në vitin 2018 nuk kemi pasur pozita të reja të lejuara me Ligj të Buxhetit, tani aktualisht janë të punësuar dymbëdhjetë (12) nëpunës, duke përfshirë Drejtorin e AMKMK-së që është i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nevojat për punëtor të rinj dhe avancimet në AMKMK parashihen:

-I- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:

1. Udhëheqës i Divizionit për Gis dhe IT – 1 pozitë;
2. Zyrtar i Logjistikës – 1 pozitë;
3. Zyrtar për informim – 1 pozitë;
4. Zyrtar për personel – 1 pozitë;
5. Zyrtar për financa – 1 pozitë;
6. Zyrtar i lartë i prokurimit – 1 pozitë;
7. Auditor i brendshëm – 1 pozitë.

-II- Departamenti për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim të Komplekseve:

1. Udhëheqës i Divizionit të Planifikimit projektimit dhe ndërtimit;
2. Zyrtar i lartë - Arkitekt;
3. Cicerona – 3 pozita.

4.4. Tabela e Trajnimeve 2018

Nr.	Fusha e Trajnimit	Trajnimi	Muaji
1.	Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore	Motivimi dhe Udhëheqja e Punonjësve në Organizatë	Mars
		Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore	Qershor
		Metodat e testimit në procesin e rekrutimit.	Prill
		Menaxhimi i Resurseve Njerëzore dhe Vlerësimi i Performances në Institucionit Publike të Kosovës	
		Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga N.SH “KMI” me temën “Menaxhimi i Proceseve Buxhetore nga Planifikimi deri në Auditimin e tyre”, mbajtur në Stamboll, Turqi, me dt. 17-20.05.2018	Maj
		Trajnim në Thesar – MF për Modulin e Shpenzimeve bashkëngjitja e faturave në dritaren e kuponit të shpenzimeve	Gusht
		Ndikimi i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në procedurën e rekrutimit dhe procedurën e ankesave	Shtator
2.	Legjislacion	Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga N.SH “KMI” me temën “Menaxhimi i Proceseve Buxhetore nga Planifikimi deri në Auditimin e tyre”, mbajtur në Stamboll, Turqi, me dt. 17-20.05.2018	Maj
		Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA) Trajnim në fushën Administrate dhe Legjislacion më temën Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA) i mbajtur nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Projekti: Mbështetje për Procesin e Reformës së Administratës Publike të Financuar nga Bashkimi Evropian (Projekt i Bashkimit Evropian) me datë 29-30.11.2018.	Nëntor
		Menaxhimi i pasurise jofinanciare, i dokumenteve dhe protokolli- arkivimi. Pergatitja elistes se dokumentave me afate te ruajtjes prej 07 -10.dhjetor 2018 Budva.	Dhjetor
3.	Arkivë	Menaxhimi i pasurise jofinanciare, i dokumenteve dhe protokolli- arkivimi	Dhjetor

		Përgatitja e listës së dokumentave me afatet e ruajtjes prej 07 -10.dhjetor 2018 Budva.	
4.	Prokurim	Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga FLSA L.L.C me temën: Rëndësia e Burimeve Njerëzore në Menaxhimin Strategjik të Buxhetit dhe Prokurimit. Më 6-9 prill 2018, Dubrovnik-Kroaci. Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga FLSA L.L.C me temën: E – Prokurimi në perspektivë të rolit të auditorëve, zyrtarëve të prokurimit, menaxherëve të kontratave, komisioneve vlerësuese dhe ekzekutimi i buxhetit në bazë të kushteve të kontratës. Më 06 - 09 dhjetor 2018, në Stamboll - Turqi,	Prill Dhjetor
5.	Buxhet dhe Financa	Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga MF me temën: “Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021”. Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga N.SH “KMI” me temën “Menaxhimi i Proceseve Buxhetore nga Planifikimi deri në Auditimin e tyre”, mbajtur në Stamboll, Turqi, me dt. 17-20.05.2018 (katër zyrtar) Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga FLSA L.L.C me temën: E – Prokurimi në perspektivë të rolit të auditorëve, zyrtarëve të prokurimit, menaxherëve të kontratave, komisioneve vlerësuese dhe ekzekutimi i buxhetit në bazë të kushteve të kontratës. Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Financave me mbështetje të GIZ-it, me temën: “Zbatimi i Rregullave Financiare të MF-së gjatë Planifikimit, Ekzekutimit dhe Raportimit Financiar të Buxhetit”..	Prill Maj Dhjetor Nëntor

4.5. PLANI VJETOR I TRAJNIMIT I NËPUNËSVE CIVIL për periudhën Janar 2019 – Dhjetor 2019

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësve civil që duhen trajnuar	Përshtatja * me prioritetet e trajnimit	Titulli i programit/kursit të trajnimit dhe kohëzgjatja e tij (nëse dihet)		Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Menaxhim i përgjithshëm	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Lidershipi dhe menaxhimi	3 ditë	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave	3	IKAP	Mars
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi dhe vendimmarrja	3	IKAP	Maj
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Bazat e menaxhimit-Logjistikes	3	IKAP	Qershor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi Strategjik	3	IKAP	Korrik
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Sjellje organizative	3	IKAP	Gusht

	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i inovacioneve	3	IKAP	Shtator
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Zyrtar i informimit dhe qasja ndaj publikut	3	IKAP	Qershor
	5	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Trajnimi per ciceron	7	IKAP	Maj
Trajnime nga fusha Burimeve Njerëzore	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi, Rekrutimi dhe përzgjedhja	3	IKAP	Shkurt
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vendosja e objektivave dhe vlerësimi të rezultateve ne punë	3	IKAP	Mars
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Transferimi dhe promovimi ne shërbimin civil	3	IKAP	Maj
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Ankimimi dhe çështjet e disiplinës	3	IKAP	Qershor

	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe ndërtimi i planave të trajnimit	3	IKAP	Shtator
Administratë dhe Legjislacion	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartimi i koncept dokumenteve	3	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Procedura administrative	3	IKAP	Mars
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale	Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike	3	IKAP	Prill
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Komunikimi dhe hartimi i shkresave në administratë publike	3	IKAP	Maj
Prokurimi Publik	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi i mallrave	3	IKAP	Shkurt
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat	Prokurimi i Shërbimeve	3	IKAP	Mars

		individuale.				
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi për punë	3	IKAP	Prill
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Standardet Ndërkombëtar e dhe Legjislacioni i Prokurimit Publik	3	IKAP	Maj
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi elektronik – (pranimi i ankesave në mënyrë elektronike)	3	IKAP	Qershor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Trajnimit e avancuar për prokurimi publik	3	IKAP	Shtator
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi Publik Parimet bazë Zbatimi i kontratave	3	IKAP	Tetor
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Krahasimi i legjislacionit për PP me vendet e BE-së	3	IKAP	Nëntor
Buxhet dhe Financa	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Nëntë Mujore (PNM)	3	IKAP	Shkurt

	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)	3	IKAP	Mars
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Kontrolli dhe Menaxhimi i Brendshëm Financiar	3	IKAP	Prill
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i financave publike	3	IKAP	Maj
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Partneriteti publiko-privat	3	IKAP	Tetor
	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale	Kontrolli i shpenzimeve dhe menaxhimi i financave	3	IKAP	Qershor
Auditimi	1	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale.	Auditim dhe qasja ndaj problemit	2	IKAP	Qershor

4.6. Asetet që ka në disponim AMKMK

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizimi	Vlera në libër
201400000 0007377	NDËRTIMI I GYPIT PËR FURNIZIM	31400	UJESJELLESI	795,114.95	0.00	127,218.38	667,896.57
201400000 0007393	KRIJIMI I WEB-FAQES SË AMKMK-	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	6,850.00	0.00	2,911.25	3,938.75
201400000 0007610	DEFINIMI I KUFIRIT TE Z.V K.M	31900	KAPITAL TJETER	39,499.74	0.00	16,787.38	22,712.36
201400000 0007623	MBIKQYRJA E PROJEKTIT NDERTIM	31400	UJESJELLESI	9,780.28	0.00	1,564.84	8,215.44
201400000 0008145	HARTIMI I PLANIT TË MENAXH. K	31900	KAPITAL TJETER	44,900.00	0.00	17,960.00	26,940.00
8743	NDERTIMI I RRUGËS	31200	NDERTIMI I RRUGEVE	9,870.56	0.00	1,521.72	8,348.84
8903	HARTIMI I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,790.00	0.00	3,018.58	6,771.42
8906	MATJET GJEOMEKANIKE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,893.00	0.00	3,132.78	6,760.22
9203	PLOTESIM I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,569.60	0.00	3,110.12	6,459.48
9208	KANALIZIMIT ATMOSFERIK	31250	KANALIZIMI	9,962.00	0.00	1,195.44	8,766.56
9211	HARTIMI I TERMAVE TE REFERENCE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,490.00	0.00	3,163.33	6,326.67
9215	ELABORATIT I SHPRONËSIMIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,789.00	0.00	3,507.72	6,281.28
10141	MBIKQYRJA E PUNIMEVE - PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,800.00	0.00	3,021.67	6,778.33
10146	MBIKQYRJA E PUNIMEVE - MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,689.00	0.00	2,906.70	6,782.30
10147	MBIKQYRJA E PUNIMEVE - KOSHARE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,950.00	0.00	2,985.00	6,965.00
10290	PUNËT SHITESË-MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	31,329.58	0.00	9,398.88	21,930.70

10309	SANIMI I DËMEVE- PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	30,967.74	0.00	9,290.32	21,677.42
10669	HART.PROJEKTI T TË KONZERVIMIT	31900	KAPITAL TJETER	491,964.00	0.00	172,187.40	319,776.60
13421	VETURË KIA SPORTAGE	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	7,615.24	12,374.76
13424	VETURË KIA SPORTAGE	31706	VETURA ZYRTARE	19,990.00	0.00	7,615.24	12,374.76
15584	EKZEKUTIMI I PUNIMEVE K.M MARINË	31900	KAPITAL TJETER	313,032.15	0.00	75,649.44	237,382.71
15590	PUNËT SHITESË- KOSHARE	31900	KAPITAL TJETER	131,222.23	0.00	34,992.59	96,229.64
15592	PUNËT SHITESË- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	29,310.38	0.00	7,816.11	21,494.27
15599	EKZEKUTIMI I PUNËVE- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	301,144.06	0.00	80,305.08	220,838.98
20316	PUNËT SHITESË- KAÇANOLL	31900	KAPITAL TJETER	6,687.80	0.00	1,337.56	5,350.24
20522	BAZAMENTI- HYRË EMINI- FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETER	8,061.00	0.00	1,612.20	6,448.80
20533	BAZAMENTI- WILLIAM WALKER- RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	69,611.70	0.00	13,822.34	55,689.36
20541	PUNËT SHITESË- BAZAMENTI RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	6,780.50	0.00	1,356.10	5,424.40
20582	SHTATORJA “HYRË EMINI”- FERIZAJ	31900	KAPITAL TJETER	49,500.00	0.00	9,900.00	39,600.00
20591	SHTATORJA “WILLIAM WALKER”- RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	98,892.96	0.00	19,778.60	79,114.36
20637	DRENAZHIMI I VARREZAVE- KOSHARE	31250	KANALIZIMI	33,499.30	0.00	2,679.94	30,819.36
25227	KANALIZIMI- K.M-RAÇAK	31250	KANALIZIMI	6,019.29	0.00	300.96	5,718.33
25228	PUNËT SHITESË- K.M-RAÇAK	31900	KAPITAL TJETER	8,609.04	0.00	1,076.13	7,532.91

25711	K.M “BETEJA E KOSHARES”-FAZA 2	31900	KAPITAL TJETER	1,348,068.21	0.00	202,210.23	1,145,857.98
25714	PUNË SHITESË-FAZA IV-K.M-MARINË	31900	KAPITA TJETER	36,750.00	0.00	5,818.75	30,931.25
25935	K.M “BETEJA E KOSHARES”-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	36,067.00	0.00	0.00	36,067.00
25973	SHPRONËSIMI-KLEÇKË-DIVJAKË	32200	PASURI FIKSE E PAPREKSHME	15,500.00	0.00	2,325.00	13,175.00
26887	PUNË SHITESË-LIKOSHAN	31900	KAPITAL TJETER	19,447.88	0.00	2,268.92	17,178.96
26923	K.M”27 PRILLI”-MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	260,508.00	0.00	0.00	260,508.00
26925	PUNË SHITESË-K.M-MEJE, GJAKOVË	31900	KAPITAL TJETER	35,916.65	0.00	4,788.89	31,127.76
28224	K.M “BETEJA E KOSHARES”-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	97,162.80	0.00	0.00	97,162.80
28235	K.M “BETEJA E KOSHARES”-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	21,404.00	0.00	0.00	21,404.00
28260	K.M “MASAKRA E RAÇAKUT”	31900	KAPITAL TJETER	109,002.00	0.00	11,808.55	97,193.45
28263	K.M “BETEJA E KOSHARES”-FAZA3	32500	INVESTIMET NË VIJIM	55,277.00	0.00	0.00	55,277.00
28269	PUNIMET FAZA IV K.M-MARINË	31900	KAPITAL TJETER	374,964.93	0.00	40,621.20	334,343.73
28998	K.M “27 PRILLI”-MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	70,000.00	0.00	0.00	70,000.00
29011	K.M “27 PRILLI”-MEJE	32500	INVESTIMET NË VIJIM	3,500.50	0.00	0.00	3,500.50
29034	RISHIKIMI I PROJEKTIT TË KONSERVIMIT	32200	PASURI FIKSE E PAPREKSHME	50,000.00	0.00	5,000.00	45,000.00
29276	K.M “DEMË AHMETI”-PODUJEVË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	170,000.00	0.00	0.00	170,000.00
29472	K.M “DËSHMORËT E UÇK-SË”-PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	629,500.97	0.00	62,950.09	566,550.88

29489	PUNË SHITESË- K.M-PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	60,172.01	0.00	9,025.80	51,146.21
29507	K.M “MASAKRA E LIKOSHANIT”	31900	KAPITAL TJETER	198,999.01	0.00	19,899.90	179,099.11
31857	RINDËRTIMI I K.M-KAÇANOLL	31900	KAPITAL TJETER	93,300.00	0.00	18,660.00	74,640.00
32875	NDËRTIMI I SHTATOREVE – PODUJEVË	31900	KAPITAL TJETËR	248,000.00	0.00	20,666.67	227,333.33
32880	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	121,804.20	0.00	0.00	121,804.20
33745	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	118,400.00	0.00	0.00	118,400.00
33750	PUNË SHITESË KLEÇKË DHE DIVJAKË	31900	KAPITAL TJETER	48,690.22	0.00	2,840.26	45,849.96
33751	K.M “DEMË AHMETI”- PODUJEVË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	100,000.00	0.00	0.00	100,000.00
33752	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	81,520.00	0.00	0.00	81,520.00
33905	K.M “MASAKRA E LIKOSHANIT”- FAZA II	31900	KAPITAL TJETËR	98,157.70	0.00	5,725.87	92,431.83
35667	RREGULLIMI I VARREZAVE – DYZ	31900	KAPITAL TJETËR	87,855.76	0.00	3,660.66	84,195.10
35668	SANIMI I DËMËVE NË LIKOVÇ	31900	KAPITAL TJETËR	3,459.50	0.00	144.15	3,315.35
35671	VAZHDIMI I PROJEKTIT- NEGROVÇ	31900	KAPITAL TJETËR	9,197.53	0.00	383.23	8,814.30
35732	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	30,313.00	0.00	0.00	30,313.00
35734	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	41,170.00	0.00	0.00	41,170.00
35851	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	28,495.00	0.00	0.00	28,495.00

35852	KONZERVIMI I MOZAIKUT – PREKAZ	31900	KAPITAL TJETËR	9,743.50	0.00	324.78	9,418.72
35853	AVANS – KLEÇKË DHE DIVJAKË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	119,895.66	0.00	0.00	119,895.66
37245	RIPARIMI I VARREZAVE – KLEÇKË	31900	KAPITAL TJETËR	63,081.35	0.00	2,102.71	60,978.64
37247	K.M “BETEJA E KOSHARES”- FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	101,709.50	0.00	0.00	101,709.50
37252	MEMORIALI I BERISHËVE – SUHAREKË	32500	INVESTIMET NË VIJIM	19,820.84	0.00	0.00	19,820.84
37253	K.M “MASAKRA E RAÇAKUT” – FAZA II	32500	INVESTIMET NË VIJIM	31,500.00	0.00	0.00	31,500.00
37254	K.M – GOROZHUP, PRIZREN	32500	INVESTIMET NË VIJIM	25,384.00	0.00	0.00	25,384.00
37257	KONSERVIMI I VETURËS NË LUPQ	31900	KAPITAL TJETËR	5,950.23	0.00	347.10	5,603.13
37426	PUNË SHITESË- K.M – VRELLË	31900	KAPITAL TJETËR	75,173.13	0.00	1,879.33	73,293.80
37851	K.M – MARINË	31900	KAPITAL TJETËR	23,012.80	0.00	383.55	22,629.25
37853	AVANS K.M “27 PRILLI”- MEJE – FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	51,674.76	0.00	0.00	51,674.76
37854	K.M “MASAKRA E RAÇAKUT”- FAZA II	32500	INVESTIMET NË VIJIM	24,400.00	0.00	0.00	24,400.00
38262	K.M “KLEÇKË DHE DIVJAKË”- FAZA II	32500	INVESTIMET NË VIJIM	110,106.08	0.00	0.00	110,106.08
38263	K.M “BETEJA E KOSHARES” – FAZA III	32500	INVESTIMET NË VIJIM	106,779.50	0.00	0.00	106,779.50
38608	VARREZAT E DËSHMORËVE NEGROVC	31900	KAPITAL TJETËR	55,768.73	0.00	929.48	54,839.25
38609	SHESHI "A.JASHARI"- MALISHEVË	31900	KAPITAL TJETËR	49,022.40	0.00	817.04	48,205.36

38638	PANASONIC TEL.LEVIZËS+C ENTRALA	31630	TELEFONA	1,086.78	0.00	22.64	1,064.14
38641	CANON EOS 77D+ÇANTA+TR IPOD	31690	"PAISJE TJERA	1,747.90	0.00	48.55	1,699.35
38642	ACER VIDEO PROJEKTOR X1123H	31600	PAISJE TJERA"	1,117.91	0.00	62.11	1,055.80
38730	SHTATORJA "ANTON ÇETA"	31900	PAJI TE TKENOLOGJIS E INFORMATIVE	69,800.00	0.00	581.67	69,218.33
38736	SHESHI "A.JASHARI"- MALISHEVË-2	31900	KAPITAL TJETER	20,978.80	0.00	349.65	20,629.15
40875	MEMORIALI I BERISHËVE- SUHAREKË	32500	KAPITAL TJETER	53,138.80	0.00	0.00	53,138.80
41366	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË FAZA II	32500	INVESTIMET NE VIJIM	26,231.49	0.00	0.00	26,231.49
41376	K.M - GOROZHUP, PRIZREN	32500	INVESTIMET NE VIJIM	25,720.00	0.00	0.00	25,720.00
41384	K.M"MASAKRA E RAÇAKUT"- FAZA 2	32500	INVESTIMET NE VIJIM	36,600.00	0.00	0.00	36,600.00
41396	VENDOSJA E KAMERAVE- PREKAZ	31600	PAJI TE TKENOLOGJIS E INFORMATIVE	94,899.40	0.00	2,636.09	92,263.31
41421	SANIMI I DËMËVE NË LIKOVÇ-F.II	31900	KAPITAL TJETER	9,745.40	0.00	81.21	9,664.19
41433	K.M "27 PRILLI"- MEJE- FAZA III	32500	INVESTIMET NE VIJIM	58,854.00	0.00	0.00	58,854.00
41474	K.M"MASAKRA E RAÇAKUT"- FAZA 2	32500	INVESTIMET NE VIJIM	7,500.00	0.00	0.00	7,500.00
41488	K.M - GOROZHUP, PRIZREN	32500	INVESTIMET NE VIJIM	33,148.80	0.00	0.00	33,148.80
41499	K.M"BETEJA E KOSHARES"- FAZA3	32500	INVESTIMET NE VIJIM	81,182.00	0.00	0.00	81,182.00

41512	MEMORIALI I BERISHËVE- SUHAREKË	32500	INVESTIMET NE VIJIM	18,968.30	0.00	0.00	18,968.30
41525	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË- FAZA II	32500	INVESTIMET NE VIJIM	62,558.70	0.00	0.00	62,558.70
41536	K.M - DYZ, PODUJEVË - FAZA II	31900	KAPITAL TJETER	29,874.00	0.00	0.00	29,874.00
41543	MEMORIALI I BERISHËVE- SUHAREKË	32500	INVESTIMET NE VIJIM	102,120.06	0.00	0.00	102,120.06
41554	HARTIMI I PROJEKTIT - GLLOGJAN	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	90,000.00	0.00	0.00	90,000.00
41562	PUNË SHITESË- KLEÇKË & DIVJAKË	31900	KAPITAL TJETER	6,200.00	0.00	0.00	6,200.00
41572	K.M"BETEJA E KOSHARES"- FAZA3	32500	INVESTIMET NE VIJIM	77,575.80	0.00	0.00	77,575.80
41732	BAZAMENTI- EDMOND HOXHA-JUNIK	32500	INVESTIMET NE VIJIM	30,782.00	0.00	0.00	30,782.00
41740	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË- FAZA 2	32500	INVESTIMET NE VIJIM	3,737.18	0.00	0.00	3,737.18
41753	K.M "27 PRILLI"- MEJE- FAZA III	32500	INVESTIMET NE VIJIM	53,335.89	0.00	0.00	53,335.89
41767	SHESHI-HASAN PRISHTINA- VUSHTRR	31900	KAPITAL TJETER	176,228.17	0.00	0.00	176,228.17
41787	SANIMI I DËMËVE NË K.M PREKAZ	31900	KAPITAL TJETER	64,633.32	0.00	0.00	64,633.32
41835	K.M-KLEÇKË DHE DIVJAKË- FAZA I	31900	KAPITAL TJETER	488,738.36	0.00	4,072.82	484,665.54
41854	K.M"DËSHMORE T E KOMBIT"- VRELLË	31900	KAPITAL TJETER	785,633.20	0.00	6,546.94	779,086.26
41879	MEMORIALI "IBRAHIM RUGOVA"	32500	INVESTIMET NE VIJIM	60,230.00	0.00	0.00	60,230.00
41902	MEMORIALI "IBRAHIM RUGOVA"	32500	INVESTIMET NE VIJIM	60,127.70	0.00	0.00	60,127.70

41923	MEMORIALI "IBRAHIM RUGOVA"	32500	INVESTIMET NE VIJIM	46,004.60	0.00	0.00	46,004.60
41932	MEMORIALI "IBRAHIM RUGOVA"	32500	INVESTIMET NE VIJIM	17,454.30	0.00	0.00	17,454.30
42170	VARREZAT- DËSHMOREVE- NEGROVC	32500	INVESTIMET NE VIJIM	10,558.05	0.00	0.00	10,558.05
42184	K.M"DËSHMORE T E UÇK-SË"- PENUHË	31900	KAPITAL TJETER	141,449.01	0.00	0.00	141,449.01
				11,074,146.13	0.00	1,090,822.88	9,983,323.25
TOTAL:				11,074,146.13	0.00	1,090,822.88	9,983,323.25

AMKMK-ja, sipas ligjit obligohet të menaxhojë me të gjitha asetet e veta në Komplekset Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

4.7. Hapësira për punë:

AMKMK-ja është e vendosur në ndërtesën e objektit të ish Gjykatës Themelore Prishtinë, dhe ka hapësirë jo të mjaftueshme për këtë numër të stafit të punëtorëve e sidomos tani në vitin 2019 kur duhet të punësohen edhe disa punëtorë të ri, pra me shtimin e numrit të zyrtarëve duhet të shtohen edhe zyrat.

5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

Aktivitetet të cilat janë ndërmarrë gjatë vitit 2018:

- Ekzekutimi i punimeve të Komplekseve dhe Memorialëve sipas Ligjit të Agjencisë ku nje pjesë janë ekzekutuar, ndërsa pjesa tjetër pritet të ekzkeutohen viteve tjera;
- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2018;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2019;
- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2018;
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2019;
- Zbatimi i planit te personelit per 2018
- Planifikimi i personelit për vitin 2019;

5.1. Planet që parashikohen për vitin - 2019

- Bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK që kanë të bëjnë me komplekset dhe memorialët;
 - Mirëmbajtja e veb-faqes së AMKMK-së dhe K.M Adem Jashari, Prekaz–Skenderaj-2017 vazhdon;
 - Bashkëpunimi me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
 - Plotësimi i stafit me punëtor të ri;
 - Procedurat e reja për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, sipas Ligjit të ri Nr.06/L-059;
 - Hartimi i Projekt strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së, e cila deri me tani nuk është hartuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore;
 - AMKMK do të vazhdoj të parashtoj kërkesat për rritjen e stafit dhe për projekte kapitale në Ministri të Financave;
 - Projektimi, Ekzekutimi dhe Menaxhimi i Komplekseve Memoriale të Kosovës.
- Agjencia do të bëjë përpjekje për realizimin e këtyre planeve gjatë vitit 2019.

Procedurat e prokurimit që janë zhvilluar për vitin 2018:

A) Procedurat për furnizim:

1. Furnizimi me material, montimi dhe konservimi i veturës se UÇK-së - Lupç, Podujevë.
2. Furnizimi dhe vendosja e Kamerave për K.M. Adem Jashari,Prekaz.
3. Furnizimi me material dhe Konservimi i Mozaikut të Komandantit Legjendar “Adem Jashari”, Prekaz –Skenderaj.
4. Furnizim me inventar për AMKMK.
5. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative dhe material zyrtarë në AMKMK.

6. Furnizimi dhe Vendosja e Shtyllave të Flamujve dhe Mbajtëseve në KM. Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Marinë, Skenderaj.
7. Blerja e Kompjuterit – AMKMK.
8. Furnizim me kimikë, fletore, kalendar (artikujt të jenë me llogo të AMKMK-së) për nevojat e AMKMK-së.

B) Procedurat për shërbime:

1. Hartimi i elaboratit për shpronësim në Komplexin Memorial- Demë Ahmeti, Podujevë.
2. Mirëmbajtja e Komplexit Memorial Dëshmorët e UÇK-së në Penuhë, Podujevë.
3. Vendosja e Tabelave Orientuese për K.M. “Adem Jashari” Prekaz.
4. Mirëmbajtja e Memorialëve :Izbicë, Likovc, Likoshan dhe Rezallë.
5. Mbikëqyrja profesionale e punimeve në projektin: Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së III-të si dhe Konservimi i Kazermës dhe Istikameve në K.M. “Beteja e Koshares” – Koshare.
6. Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë, Malet e Berishës.
7. Pastrimi i Hapësirës në KM Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Marinë, Skenderaj.
8. Hartimi i Projektit për Ndërtimin e Gypit të Ujitjes në KM. Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së – Marinë, Skenderaj.
9. Shërbime Profesionale –Konsulente.

C) Procedurat për punë:

1. Restaurimi dhe Konservimi i objekteve ndihmëse të familjes Ahmeti -faza II në K.M. "Masakra e Likoshanit", Likoshan – Drenas.
2. Ndërtimi dhe rregullimi i sheshit "Adem Jashari", Malishevë.
3. Rregullimi dhe riparimi i varrezave të Dëshmorëve , Negrovç-Drenas.
4. Ndërtimi i Memorialit të Berishëve në qytetin e Suharekës.
5. Sanimi i dëmtimeve në Qendrën e Shtabit të Përgjithshëm Likovc, Skenderaj.
6. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve në Dyz, Podujevë – Faza I-rë.
7. Punët shtesë në projektin: Ekzekutimi i punëve në Restaurimin dhe Konservimin e Objekteve brenda ZIV “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK – së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës.
8. Vazhdimi (plotësimi) i projektit Rregullimi dhe riparimi i varrezave të Dëshmorëve, Negrovç-Drenas.

9. Ekzekutimi i punëve në Restaurimin dhe Konservimin e objekteve brenda ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës – Faza e II-të.
10. Ekzekutimi i punëve në riparimin e dëmtimeve të Varrezave dhe vendosja e Pllakës Përkujtimore në Varrezat e Dëshmorëve Kleçkë - ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK- së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës.
11. Ekzekutimi i Fazës së Rivarrimit të Dëshmorëve në KM Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Marinë, Skenderaj.
12. Ekzekutimi i Punëve në K M "Masakra e Raçakut" Raçak, Shtime faza e –II- të.
13. Ekzekutimi (vazhdimi) i punëve në ndërtimin dhe rregullimi i Sheshit "Adem Jashari", Malishevë -Faza II-të.
14. Ndërtimi i Infrastrukturës përcjellëse të Shtigjeve dhe Lapidarëve Përkujtimor ku ka rënë Mujë Krasniqi dhe dyzet Bashkëluftëtarët në fshatin Gorozhup në rajonin e Hasit – Komuna e Prizrenit.
15. Ekzekutimi i fazës së III-të në K.M. "27 Prilli" Mejë-Gjakovë.
16. Ekzekutimi i punimeve në rinovimin e Bazamentit të Shtatores së Dëshmorit "Edmond Hoxha" – Junik.
17. Ekzekutimi i punimeve në ndërtimin e Gypit të Ujitjes në K M Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së – Marinë, Skenderaj.
18. Sanimi i dëmtimeve në Qendrën e Shtabit të Përgjithshëm Likovc, Skenderaj – Faza II-të.
19. Vazhdimi i Rivarrimit të Dëshmorëve dhe punimeve në vazhdim "Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së Penuhë " – Podujevë.
20. Ekzekutimi i punimeve në rregullimin e Parkingut për Varrezat e Dëshmorëve, Negrovç – Drenas.
21. Ekzekutimi i punimeve në rregullimin e Varrezave të Dëshmorëve në Dyz, Podujevë-faza II.
22. Sanimi i dëmtimeve nga Reshjet Atmosferike dhe Era në KM. "Adem Jashari" – Prekaz, Skenderaj.
23. Punët shtesë - ndërtimi i Memorialit Berisha në Qytetin e Suharekës.
24. Punët shtesë në ekzekutimi i punëve në riparimin e dëmtimeve të Varrezave dhe vendosja e Pllakës Përkujtimore në Varrezat e Dëshmorëve Kleçkë - ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK- së Kleçkë dhe Divjakë - Malet e Berishës.
25. Punët shtesë - Ndërtimi i Infrastrukturës Përcjellëse e Shtigjeve dhe Lapidarëve Përkujtimor ku ka Rënë Mujë Krasniqi dhe dyzet Bashkëluftëtarët në fshatin Gorozhup në Rajonin e Hasit - Komuna e Prizrenit.

D) Procedurat e projektimit:

1. Ngritja e shtatores së Anton Çetës, në Prishtinë.

Procedurat e prokurimit që do të zhvillohen për vitin 2019:

1. Kompleksi Memorial "Adem Jashari " Prekaz – Skenderaj;
2. Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial "Adem Jashari " Prekaz – Skenderaj;
3. Kompleksi Memorial “Masakra e Raçakut” Raçak – Shtime;
4. Kompleksi i Varrezave “Dëshmorët e UÇK-së” Marinë – Skenderaj;
5. Kompleksi Memorial “Zona e Interesit të Veçantë Beteja e Koshares” Koshare;
6. Kompleksi Memorial “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë-Malet e Berishës;
7. Kompleksi “Kulla Zahir Pajaziti” Orllan, Podujevë;
8. Memoriali “Ibrahim Rugova” Prishtinë;
9. Kompleksi i varrezave të “Dëshmorëve” të UÇK-së” Penuhë, Podujevë;
10. Memoriali Masakra e Likoshanit – Drenas;
11. Ngritja e Shtatores Anton Çeta, Prishtinë – ndërtimi i bazamentit;
12. Memoriali “Baza e parë e Ilegales së UÇK-së” Lladovc, Podujevë;
13. Kompleksi Memorial “Shtabi I UÇK-së dhe Varrezat e Dëshmorëve” Gllogjan, Deçan;
14. Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së Shqiponjë” (ish Jabllanica)” Gjakovë;
15. Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë - Istog;
16. Kompleksi Memorial “27 Prilli” Meje, Gjakovë;
17. K M “Shtëpia e Demë Ahmetit – Reçicë, Podujevë;
18. Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve të Brigadës 121” Ismet Jashari” në Kleçkë;
19. Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Sheshin “Adem Jashari” – Malishevë;
20. Mirëmbajtja e Memorialëve; Izbicë, Likovc, Likoshan, Rezallë;
21. Mirëmbajtja e varrezave të Dëshmorëve të UÇK- së Negrovci dhe fshatrat tjera - Drenas;
22. Rregullimi i Varrezave të Dëshmoreve në Dyz – Podujevë;
23. Memoriali i Mujë Krasniqit dhe 40 dëshmorët në Kufi;
24. Memoriali “Metush Krasniqi” Dajkoc – Kamenicë;
25. Masakra e Familjes Deliu dhe Mulliqi, Abri e Epërme - Drenas;
26. Kulla e Fehmi Lladrovci – Gllanasellë - Drenas;
27. Shtabi në Kosterc dhe Varrezat e Dëshmorëve - Skenderaj;

28. Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve dhe Pllaka Përkujtimore në Çikatovë të Vjetër të Drenasit;
29. Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve në Kaçanoll dhe Dyz – Podujevë;
30. Rregullimi i Lapidarit të Dëshmorëve të UÇK- së Prigodë, Istog;
31. Lapidari i masakrës së Burgut të Dubravës – Istog;
32. Lapidari i Dëshmorëve Korroticë e Ulët – Drenas;
33. Lapidari i Dëshmorëve të UÇK-së Komoran – Drenas;
34. Lapidari i Dëshmorëve të UÇK-së Gramaçel – Deçan;
35. Lapidari i Dëshmorëve të UÇK-së Carrabreg i Epërm – Deçan;
36. Lapidari “Zahir Pajaziti” Pestovë – Vushtrri;
37. Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së – Junik;
38. Memoriali “Parku i Dëshmorëve” - Suharekë;
39. Obelisku i fëmijëve të vrarë Aeroport – Sllatinë – Lipjan – Prishtinë;
40. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Fshatrat e Skenderajt;
41. Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Skenderajt;
42. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Viti dhe Derdhja në Bronz i Busteve të Gurësel e Bajram Sylejmanit – Sadovinë;
43. Ndërtimi Përkujtimor – Jabllanicë e Vogël – Pejë;
44. Riparimi i Varrezave në Qyshk – Pejë;
45. Konzervimi i Shtëpisë ku është kryer masakra në Poklek të Vjetër – Drenas;
46. Lapidari “Hyzri Talla” në Breg të Diellit – Prishtinë;
47. Ndërtimi i Shtatores së Adem Jasharit në Fushë Kosovë;
48. Ndërtimi i shtatores së Heroit Ahmet Krasniqi në sheshin ‘Ahmet Krasniqi’ në Vushtrri.

Projektet Kapitale të përfshira në Sistemin e PIP-it të pa Buxhetuara:

1. Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale- Varreza të Dëshmorëve dhe Martirëve etj;
2. Memoriali “ Obelisku Afrim Zhitia” Llugë - Podujevë;
3. Memoriali “Fshati Muze Struzhë” Kaçanik;
4. Memoriali “Dëshmorët” e UÇK-së” Landovicë, Prizren;

6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Agjencia ka linjë të pavarur buxhetore duke iu përmbajtur Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Agjencia prej themelimit ka pasur shumë sfida, si mungesa e buxhetit, mungesa e stafit, ngecja dhe mos bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona, si:

- Rritja e numrit të punëtorëve të AMKMK-së: punësimi i stafit në administratë, punësimit të ciceronëve, rojeve dhe mirëmbajtja e komplekseve memoriale;

- Rritja e buxhetit për projekte kapitale - Komplekseve Memoriale;

- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe

- Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetore në këtë linjë nuk i mbulon shpenzimet për të gjitha Komplekset dhe Memorialët, andaj kërkojmë që për kryerjen e këtyre obligimeve pa ndërlikime të ndahen mjete të mjaftueshme financiare.

Konsiderojmë se për funksionalizimin e Agjencisë duhet të trajtohet kjo çështje nga Komisioni funksional BPMPH, Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe në anën tjetër edhe Qeveria dhe Ministria e Financave.

Një prej qëllimeve që ka mbetur i pa realizuar është:

- Plotësimi i stafit në të gjitha pozitat e lira, krahas kësaj edhe shtim i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Duke pasur parasysh numrin e madh të Komplekseve dhe Memorialeve në Kosovë që parashihen të ndërtohen, menaxhohen dhe disa të ndërtuara më herët që janë dëmtuar e që duhet patjetër të sanohen dhe të mirëmbahen, është e nevojshme që të kemi buxhet dhe staf të mjaftueshëm.

Planifikimi për vitin e ardhshëm do të parashihet në arritjen e këtyre objektivave, me qëllim të ngritjes, menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve që janë përgjegjësi e AMKMK-së, përkatësisht bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve me institucionet tjera relevante.

Stafi i AMKMK-së është trajnuar dhe kualifikuar për punët dhe detyrat shtesë të domosdoshme për funksionimin më të mirë të Agjencisë.

7. Raporti Financiar

Buxheti fillestar për AMKMK-në për vitin 2018 ishte: **5,246,216.00€**; Buxheti final: 5,102,902.98€.

Kategoritë	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet 2018	%
Paga e mëditje	91,345.00	91,911.83	91,911.83	100
Mallra e shërbime	74,871.00	74,871.00	55,736.47	74.44
Shpenzim et komunale	30,000.00	39,629.65	35,016.74	88.35
Investimet kapitale	5,050,000.00	4,896,490.50	4,339,398.94	88.62
Totali	5,246,216.00	5,102,902.98	4,522,063.98	88.61

Me buxhetin e vitit 2018 kanë qenë të lejuar dymbëdhjetë (12) pozita për AMKMK-në dhe janë të plotësuara të gjitha pozitat.

Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për propozim ndryshimet në Tabelën 3.2 dhe 4.2, AMKMK ka bërë kërkesë për rialokim të mjeteve nga projekti: (15393) Ndërtimi i varrezave të dëshmorëve në fshatin Polac, Skënderaj, në projektet:

1. (15389) Ndërtimi i shtatoreve Zahirit, Edmondit dhe Hakifit në Podujevë: 18,000.00€
2. (15392) Ndërtimi i sheshit Hasan Prishtina, Vushtrri: 195,000.00€.

Ndërsa në muajin Tetor, sipas Instruksionit për përmbylljen e vitit fiskal 2018, AMKMK ka bërë kërkesë për transfere rialokime, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, neni 15 dhe neni 16, të projekteve kapitale.

Nga projekti kapital (13851) Kompleksi Memorial "Adem Jashari" është bërë transferi/rialokimi total i mjeteve 750,000.00€ në projektet dhe shpenzimet komunale, si në vijim:

1. (14647) Kompleksi Memorial "Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së", Marinë Skenderaj: 102,000.00€.
2. (15530) Varrezat e Dëshmorëve Negrov, Drenas: 25,000.00€.
3. (15551) Rregullimi i varrezave në Dyz Podujevë: 18,000.00€.
4. (14649) Kompleksi Memorial ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë Malet e Berishës": 250,000.00€.
5. (14362) Vazhdimi i punimeve në K.M "Beteja e Koshares" Koshare: 180,000.00€.
6. (14363) Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë: 145,000.00€.
7. (15808) Ngritja e shtatores së Anton Çetës, në Prishtinë: 10,000.00€.

8. Shpenzimet komunale, duke pasur parasysh shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike nëpër komplekse memoriale dhe me qëllim të mos barten obligime të mëdha në vitin 2019, është bërë transfer/rialokim nga nënkategoria ekonomike investimet kapitale, me gjithsejt shumën prej 20,000.00€.

Pas aprovimit të Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” Ministria e Financave i ka alokuar 730,000.00€ në projektin K.M “Adem Jashari”, sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 04/74 me dt. 06.11.2018.

*Ndarja finale e buxhetit ka ndryshuar për shkak të Vendimit të Qeverisë Nr. 08/76 më dt. 21.11.2018 ku janë shtuar mjetet në paga sipas kërkesës tonë me gjithsejt vlerën prej 3,300.00€, ku shuma totale e pagave është bërë 94,645.00€.

Por me Vendimin e Qeverisë më dt. 18.12.2018 janë bërë kursimet në buxhet, përkatësisht në paga, shpenzime komunale dhe investime kapitale:

Në paga kursimet janë bërë në vlerë prej 2,733.17€, ndërsa në shpenzimet komunale janë bërë kurse me vlerë prej: 10,370.35€, dhe në projektet kapitale kursimet janë bërë si në vijim:

14651 “K.M Masakra e Likoshanit”: 1,842.30€

15393 “K.M Rregullimi i varrezave në Polac”: 37,000.00€.

15396 “K.M Varrezat e Dëshmorëve Brigada 121 të UÇK-së, Ismet Jasahri Kumanova, Kleçkë”: 10,000.00€.

15804 “K.M Ndërtimi i Memorialit të Berishëve, Suharekë”: 85,904.26€.

15806 “K.M Ndërtimi i Infrastrukturës Përcjellëse të shtigjeve dhe lapidareve ku ka rënë Mujë Krasniqi me 40 luftëtarë të tjerë”: 49,000.00€.

15807 “K.M Projekti Ish Qendra e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së”: 36,795.10€.

Por me Vendimin e Qeverisë më dt. 28.12.2018 janë bërë kursimet në buxhet, përkatësisht në investime kapitale.

13851 “K.M Adem Jashari”: 598,412.47€.

15804 “K.M Ndërtimi i Memorialit të Berishëve, Suharekë”: 20,047.74€.

15806 “K.M Ndërtimi i Infrastrukturës Përcjellëse të shtigjeve dhe lapidareve ku ka rënë Mujë Krasniqi me 40 luftëtarë të tjerë”: 24,507.63€.

Këtij Raporti Vjetor të Punës do t’ia bashkangjesim edhe Raportin Vjetor Financar 2018 të AMKMK-së.

8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke marrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që të gjitha shpenzimet të planifikohen, evidentohen dhe raportohen drejtë në kategoritë përkatëse të tyre në përputhje me planin kontabël.	Fillimisht projekti "Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" – Prekaz, dhe Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial "Zahir Pajzaiti janë projekte të ndara me buxhet të veçantë dhe kod të projektit në sistemin e PIP-it të Ministrisë së Financave, prandaj edhe pagesa kryhet prej kategorisë së kapitaleve dhe nuk mund të bëhet pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.	Gjatë vitit 2018	Keqklasifikim i shpenzimeve
Për pesë projekte: K.M 'Dëshmorët e UÇK-së', Penuhë, K.M 'Masakra e Raqakut', K.M '27 Prilli', Gjakovë, K.M 'Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së', Marinë dhe K.M 'Dëshmorët e Kombit' Vrellë, ishin kontraktuar punë shtesë me vlerë prej 170,203€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive që kanë projektet dhe projekttimeve jo të analizuara mirë për ndërtimin e komplekseve. Punët shtesë janë arsyetuar nga menaxheri i kontratës dhe lejohen edhe me ligj, megjithatë vërehet se është bërë dukuri e shpeshtë, dhe po përsëritet nëpër vite.	AMKMK është munduar që gjatë vitit 2018 të monitorojë hartimin e projekteve në mënyrë që të shmangen punët shtesë	Gjatë vitit 2018	Planifikimet jo të mira të projekteve rezultojnë me nevojën për ndryshime në projekte, e që kjo reflekton në krijimin e kostove shtesë. Si rezultat i kësaj, këto punë shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja

Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e - pasuria". Agjencia, ende nuk e ka në funksion programin qeveritar e-pasuria, përkundër që kishte bërë shkresa zyrtare në MAP për funksionalizimin e këtij sistemi. Në mungesë të këtij sistemi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në një formë të Exel-it, ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë dhe pa lënë gjurmë	AMKMK ka bërë kërkesa të vazhdueshme në MAP - ASHI për qasje në sistemin E-pasuria, por ende nuk kemi marrë qasje.	Gjatë vitit 2018	Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përllogaritjes manuale të zhvlerësimit. Po ashtu, kjo mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.
Edhe përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, një numër i konsiderueshëm i tyre kanë mbete në proces të zbatimit ose të pazbatuara. Këto rekomandime kanë të bëjnë me keq-klasifikimin e shpenzimeve (për të cilin është theksuar çështja), dinamikë e ngadalshme në realizimin e buxhetit për investime kapitale, dhe kontraktimi për punë shtesë jashtë kontratave bazë.	AMKMK ka hartuar planin e implementimit të rekomandimeve të ZKA	Gjatë vitit 2018	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
Sipas rregullave të MFK-së, Agjencia ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit, menaxhimit dhe monitorimit të rreziqeve. Megjithatë edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar, ai nuk është menaxhuar në mënyrë aktive për sa i përket	AMKMK ka hartuar listën e rreziqeve dhe monitorimin e listës, por, nuk ka hartuar Strategjinë dhe planin strategjik për shkak të mungesës së buxhetit për angazhim të ekspertëve	Gjatë vitit 2018	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë hartimin e planit strategjik dhe të sigurojë azhurnim efektiv dhe raportim tremujor të rreziqeve për zbatimin e kërkesave në këtë

azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet. Po ashtu, plani strategjik ende nuk ishte hartuar deri në fund të auditimit tonë.			fushë.
--	--	--	--------

9. Shtojcat

Në AMKMK janë nxjerrë Vendime të rëndësishme si:

- Vendime për Formimin e Komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e Ofertave -AMKMK;
- Vendim për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendime për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projekteve ideore, kryesore në konservimin dhe restaurimin objekteve memoriale të ndryshme;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për Komisionin Konteste dhe Ankesa dhe Komisionin për Shkelje Disiplinore;
- Vendim për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;
- AMKMK nuk ka Bord dhe nuk është Autoritet Rregullativ nuk lëshon dhe revokon Licenca.

Për realizimin e objektivave të AMKMK-së, është me rëndësi të ketë rritje të Buxhetit të Agjencisë nga Ministria e Financave. Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare dhe mos trajtimi me kompetencë i kësaj çështje nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës nuk do të mund të realizohen objektivat e parashikuara të Agjencisë.

AMKMK do të përmbushë në mënyrë efikase dhe me integritet detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i përcakton Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Ligji Nr.06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Me respekt.